

DEKLARIMI INDIVIDUAL VJETOR I TË ARDHURAVE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kujton se çdo individ rezident në Republikën e Shqipërisë, i cili përfiton të ardhura me burim në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj, në shumën mbi 2,000,000 (dy milionë) lekë në vit, në mbështetje të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është i detyruar të paraqesë Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave.

Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave është e detyrueshme të paraqitet gjithashtu edhe nga individët jo rezidentë, të cilët realizojnë të ardhura të tatueshme, me burim në Republikën e Shqipërisë, në shumën mbi 2,000,000 (dy milionë) lekë.

Detyrimin për të plotësuar DIVA e kanë gjithashtu, edhe individët rezidentë apo jo rezidentë, të cilët kanë qenë të punësuar në më shumë se 1 (një) punëdhënës, pavarësisht se totali i të ardhurave të tyre gjatë këtij viti kalendarik është nën 2.000.000 (dy milionë) lekë. Ky parashikim zbatohet për individët të cilët kanë përfituar të ardhura nga punësimi nga më shumë se një punëdhënës duke filluar nga 1 janari 2020.

Individët janë të detyruar të deklarojnë të ardhurat e tatueshme si më poshtë:

Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit

Të ardhurat bruto nga dividendi

Të ardhurat bruto nga qiraja

Fitimi kapital nga shitja e pasurisë së palujtshme në pronësi të deklaruësit

Të ardhura bruto nga interesat bankare

Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të palujtshme

Shuma bruto të fituara nga lotaria apo lojëra të tjera të fatit.

Të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuritë e tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike.

Fitimi kapitali nga dhurimi.

Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart

Deklarata DIVA, gjenerohet e paraplotësuar automatikisht me të dhënat e të ardhurave vjetore bruto nga pagat apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët, si edhe me përlllogaritjen e Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi.

Gjithashtu fushë e paraplotësuar do të jetë edhe vlera e paguar gjatë vitit për sa i takon Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi.

Pavarësisht se keto rubrika gjenerohen të paraplotësuara, do të vijojnë të jenë fusha të lira dhe të ndryshueshme, në mënyrë që deklaruesi të ketë mundësi t'i verifikojë dhe ndryshojë ato.

Plotësimi i pasaktë i Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave mund të shkaktojë vendosjen e penaliteteve për individin deklarues.

Në rastin kur shuma e të ardhurave të përfituara gjatë muajit nga dy apo më shumë paga tek punëdhënës të ndryshëm e kalojnë vlerën që tatohet me zero përqind (30,000 lekë), tatimi do të llogaritet mbi totalin e të ardhurave mujore nga pagat (totali i të ardhurave nga pagat tek të gjithë punëdhënësit).

Në bazë të shumës së pagave të përfituara në total nga të gjithë punëdhënësit, individi bën llogaritjet sipas skemës së mëposhtme:

- Për shumën e pagave mujore deri 30.000 lekë tatimi është zero përqind
- Për shumën e pagave mujore nga 30.001 lekë - 150 000 lekë tatimi është 13 përqind e shumës mbi 30 000 lekë
- Për shumën e pagave mujore nga 150 001 lekë e më tepër tatimi është 13,000 lekë plus 23 përqind e shumës mbi 150,000 lekë

Diferenca midis tatimit të llogaritur, të shënuar në kutinë 4 të deklaratës, me shumën e tatimit të paguar, të mbajtur në burim nga punëdhënësit, të shënuar në kutinë 22 të deklaratës, përfaqëson shumën e detyrimit që duhet të paguajë individi në administratën tatimore për llogari të të ardhurave të tij vjetore nga punësimet.

Shuma e tatimit të llogaritur, të vendosur në kutinë 4 të deklaratës, në asnjë rast nuk mund të jetë më e vogël se tatimi i mbajtur në burim dhe i paguar nga punëdhënësi për të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës gjatë vitit të vendosur në kutinë 22 të deklaratës.

Në rastin e individëve, të cilët në asnjë muaj të vitit nuk kanë qenë të dypunësuar, shuma e tatimit të llogaritur, të vendosur në kutinë 4 të deklaratës, është gjithmonë e barabartë me tatimin e mbajtur në burim dhe të paguar nga punëdhënësi për pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës gjatë vitit, të vendosur në kutinë 22 të deklaratës.

Kujdes: Tatimi mbi pagat dhe shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit, duhet të llogaritet vetëm për pagat dhe shpërblimet e përfituara nga individi bazuar në një marrëdhënie të rregullt punësimi dhe sipas shumave të deklaruara nga punëdhënësi në listëpagesat respektive. Çdo e ardhur tjetër, e përfituar për shkak të marrjes pjesë në Komisione të ndryshme, Komitete, borde drejtuese keshilla mbikqyrese etj, për të cilat është mbajtur paraprakisht 15 % tatim në burim nga perfituesi i shërbimit dhe nuk janë deklaruar si paga nga ky i fundit, nuk duhet të llogariten si pagë e përfituar nga individi deklarues. Totali i pagave dhe shpërblimeve të deklaruara nga individi deklarues duhet të përputhen me totalin e pagave dhe shpërblimeve të deklaruara për të nga punëdhënësit sipas deklaratave të listëpagesave respektive të administruara nga administrata tatimore.

Për më shumë informacion, mund të klikoni në faqen zyrtare të Administratës Tatimore, www.tatime.gov.al, të drejtoheni në zyrat e shërbimit ndaj tatimpaguesve ose pranë drejtorive



rajonale tatimore, si edhe të telefononi në numrin e telefonit pa pagesë **0800 00 02** pranë Qendrës së Thirrjeve.

Deklarimi i të ardhurave, përveç se është detyrim ligjor, i çdo individi subjekt i deklarimit, është edhe një garanci më shumë, lidhur me justifikimin e pasurisë së tij.

KUJDES!

Deklarata për të ardhurat individuale vjetore duhet të dorëzohet, nëpërmjet sistemit e-filing, jo më vonë se data 30 Prill e vitit që pason periudhën për të cilën bëhet deklarimi.